



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 37

2000

Nëntor

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8670 datë 26.10.2000	Për gradat dhe karrierën ushtarake në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë.....	1773
Ligj nr.8671 datë 26.10.2000	Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë	1786
Ligj nr.8677 datë 2.11.2000	Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore	1798
Ligj nr.8679 datë 2.11.2000	Për disa ndryshime në ligjin nr.7962, datë 13.7.1995 “Për energjinë elektrike”	1807
Ligj nr.8682 datë 7.11.2000	Për një ndryshim në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, ndryshuar me ligjin nr.8501, datë 16.6.1999	1808

L I G J
Nr.8670, datë 26.10.2000

**PËR GRADAT DHE KARRIERËN USHTARAKE NË FORCAT
E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Ky ligj përcakton kriteret dhe autoritetin për pranimin në Forcat e Armatosura, rendin e gradave, përparimin në gradë dhe në karrierë, përgjegjësitë që rrjedhin nga karakteri i veçantë i detyrës dhe i shërbimit ushtarak dhe ndërprerjen e karrierës për ushtarakët e Forcave të Armatosura.

Neni 2

1. Gradat ushtarake janë tituj e shenja dalluese në emërtesën e hierarkisë ushtarake.
2. Hierarkia ushtarake përfshin rendin e gradave dhe të funksioneve.
3. Rendi i gradave dhe i funksioneve në Forcat e Armatosura shkallëzohet nga më e ulta në më të lartën, sipas lidhjeve e varësive që kanë ndërmjet tyre.
4. Ushtarakët, në varësi nga vendi i tyre në hierarkinë e gradave, kanë veçoritë e më të lartit dhe më të ultit.

Neni 3

Karriera ushtarake është rendi i përgjegjësive të ushtarakut gjatë kohës që shërben në Forcat e Armatosura, sipas arsimimit, kualifikimit, aftësive drejtuese e profesionale dhe vjetërsisë së shërbimit.

Neni 4

1. Në hierarkinë ushtarake, ushtarakët janë oficerë, nënoficerë dhe ushtarë (detarë).
2. Ushtarakët e Forcave të Armatosura janë ushtarakë të shërbimit aktiv të përhershëm (të karrierës), të shërbimit aktiv të përkohshëm, të shërbimit aktiv të detyrueshëm, si dhe ushtarakë të rezervës.

Neni 5

1. a) Oficer aktiv i Forcave të Armatosura është shtetasi shqiptar që ka kryer arsimin e lartë ushtarak ose shtetasi shqiptar që ka kryer arsimin e lartë civil dhe kursin përkatës ushtarak, jo më pak se një vit në Akademinë Ushtarake, bën betimin ushtarak dhe titullohet si i tillë me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

b) Oficer në rezervë i Forcave të Armatosura është shtetasi shqiptar që ka kryer arsimin e lartë dhe, në raste të veçanta ka arsim të mesëm, ka kryer kualifikimin e nevojshëm ushtarak për specialitetin përkatës, ka bërë betimin ushtarak dhe është titulluar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes. Të tillë janë dhe oficerët aktivë të Forcave të Armatosura që dalin në rezervë.

c) Nënoficer aktiv i Forcave të Armatosura është shtetasi shqiptar që ka kryer arsimin e mesëm ose arsimin e lartë, kualifikimin përkatës të nënoficerit, që ka bërë betimin ushtarak dhe është titulluar si i tillë me urdhër të komandantit të forcës.

ç) Nënoficer në rezervë i Forcave të Armatosura është shtetasi shqiptar që ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, arsimin e mesëm, kualifikimin përkatës dhe është titulluar si i tillë nga komandanti i forcës.

d) Ushtar (detar) i Forcave të Armatosura është shtetasi shqiptar që:

- kryen shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv sipas ligjit dhe gjatë kryerjes së këtij shërbimi, bën betimin ushtarak;

- kryen shërbimin ushtarak me pagesë (kontratë);

- bën pjesë në forcat rezerviste.

2. Si oficer, nënoficer dhe ushtar aktiv me pagesë në Forcat e Armatosura pranohet shtetasi shqiptar që, përveç kritereve të përcaktuara në pikën 1 shkronja “a”, “c” dhe “d” të këtij neni, është në moshën 19 deri në 30 vjeç.

3. Në shërbimin ushtarak si oficer, nënoficer, ushtar me pagesë nuk pranohen shtetasit që janë dënuar nga gjykata për vepër penale për të cilën dënimi minimal është deri në 1 vit, që kanë humbur të drejtën e ushtrimit të profesionit ose të veprimtarisë në administratën publike me vendim gjykate dhe që ndodhen në një proces hetimor me masë sigurie.

Neni 6

Ushtarakët, me futjen e tyre në shërbimin ushtarak nënshkruajnë kontratë në këto raste:

1. Për ushtarët me pagesë:

a) Kontrata lidhet për një afat jo më pak se 3 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës përcaktohet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, por jo më e gjatë se afati fillestar.

b) Kontrata nënshkruhet ndërmjet shtetasit dhe komandantit të forcës.

2. Për nënoficerët:

a) Kontrata e parë nënshkruhet për një afat jo më pak se 6 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës përcaktohet me urdhër të komandantit të forcës, por jo më e gjatë se afati fillestar.

b) Kontrata nënshkruhet ndërmjet shtetasit dhe komandantit të forcës.

3. Për oficerët:

a) Kontrata nënshkruhet me fillimin e studimeve në shkollat e larta ushtarake (brenda dhe jashtë vendit). Në kontratë përfshihet koha e arsimimit dhe 6 vjet shërbimi në Forcat e Armatosura, me të drejtë ripërtëritjeje edhe deri 6 vjet të tjera.

b) Kontrata nënshkruhet ndërmjet shtetasit, komandantit të Akademisë Ushtarake dhe përfaqësuesit të Ministrit të Mbrojtjes (për studentët dhe oficerët).

c) Në rast shkeljeje të kontratës, ushtarakët detyrohen të dëmshpërblejnë shpenzimet për kohën e studimit (kualifikimit) brenda ose jashtë vendit. Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes për shlyerjen e detyrimit në këto raste përbën titull ekzekutiv.

Neni 7

Vjetërsia në shërbimin ushtarak e ushtarakut të Forcave të Armatosura, për efekt page, sigurimi shoqëror etj. (përveç gradës), llogaritet nga data e hyrjes në Forcat e Armatosura si ushtar, kursant (nënoficer) dhe student në shkollat e larta ushtarake.

KREU II GRADAT USHTARAKE

Neni 8

Në Forcat e Armatosura grada u jepen oficerëve e nënoficerëve të shërbimit aktiv dhe rezervë, ushtarëve (detarëve) të shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv dhe rezervë, si dhe ushtarëve me pagesë.

Neni 9

Gradat ushtarake në Forcat e Armatosura për oficerët dhe nënoficerët klasifikohen në grada të ulta, grada të larta dhe grada madhore.

Neni 10

Gradat ushtarake, sipas llojit të forcës, për ushtarët (detarët), nënoficerët dhe oficerët janë:

1. Për ushtarët (detarët) e shërbimit të detyrueshëm dhe me pagesë:

- Tetar
- Rreshter III
- Rreshter II
- Rreshter I

2. Për ushtarët (detarët) e shërbimit rezervë:

- Rreshter III
- Rreshter II
- Rreshter I

3. Për nënoficerët (për të tria llojet e forcave)

- a) Grada të ulta
 - Kapter V
 - Kapter IV
 - Kapter III
- b) Grada të larta
 - Kapter II
 - Kapter I
 - Kapter
- c) Grada madhore
 - Kryekapter

4. Për oficerët në:

- forcat tokësore - forcat detare

- forcat ajrore

a) Gradat e ulta

Nëntoger	Nënlejtant
Toger	Lejtant
Kapiten	Kapiten lejtant

b) Gradat e larta

Major	Kapiten i rangut III
Nënkolonel	Kapiten i rangut II
Kolonel	Kapiten i rangut I

c) Gradat madhore

Gjeneral brigade	Kundëradmiral
Gjeneral major	Nënadmiral
Gjeneral lejtant	Admiral
Gjeneral	

Neni 11

Koha e qëndrimit në gradë:

1. Për ushtarët (detarët) e shërbimit të detyrueshëm koha e qëndrimit në një gradë dhe fitimi i gradës pasardhëse përcaktohet nga niveli i përvetësimit të programit të përgatitjes së ushtarit dhe arrin deri në rreshter II.

- Tetar - pas 3 muajsh
- Rreshter III - pas 6 muajsh
- Rreshter II - pas 9 muajsh

2. Për ushtarët (detarët) me pagesë:

- Tetar - pas 3 muajsh
- Rreshter III - pas 6 muajsh
- Rreshter II - pas 9 muajsh
- Rreshter I - pas 2 vjetësh

3. Për ushtarët rezervistë:

- Rreshter III - 4 vjet ose 20 ditë stërvitje ushtarake
- Rreshter II - 5 vjet ose 25 ditë stërvitje ushtarake
- Rreshter I - 6 vjet ose 30 ditë stërvitje ushtarake

4. Për nënoficerët aktivë:

- Kapter V - 2 vjet
- Kapter IV - 2 vjet
- Kapter III - 4 vjet
- Kapter II - 4 vjet
- Kapter I - 5 vjet
- Kapter - 5 vjet
- Kryekapter deri në moshën e daljes në pension

5. Për nënoficerët rezervistë:

- Kapter V - 2 vjet
- Kapter IV - 2 vjet
- Kapter III - 3 vjet
- Kapter II - 5 vjet
- Kapter I - 5 vjet
- Kapter - 5 vjet
- Kryekapter - 5 vjet

6. Për oficerët aktivë:

- Nëntoger Nënlejtant - 3 vjet
- Toger Lejtant - 4 vjet
- Kapiten Kapiten lejtant - 5 vjet
- Major Kapiten i rangut III - 4 vjet
- Nënkolonel Kapiten i rangut II - 5 vjet
- Kolonel Kapiten i rangut I - 5 vjet

Dhënia e gradës gjeneral brigade deri në gjeneral bëhet mbi bazën e aftësive profesionale dhe pa afate të qëndrimit në gradë.

7. Oficerët, që kanë fituar gradat e larta major, deri kolonel dhe që shërbejnë në specialitete si inxhinierë, mjekë, ekonomistë-financierë, juristë dhe specialitete të tjera të ngjashme në Forcat e Armatosura, të përcaktuara nga Ministri i Mbrojtjes, si dhe nënoficerët që kanë fituar gradat e larta kapter II deri kryekapter, në rast se nuk fitojnë gradën tjetër të lartë, qëndrojnë në këtë gradë deri në kohën e daljes në pension.

8. Për oficerët rezervistë që nuk kanë qenë oficerë aktivë:

- Toger - 4 vjet
- Kapiten - 5 vjet
- Major - 6 vjet
- Nënkolonel - 8 vjet

Neni 12

Koha maksimale e qëndrimit në një gradë është:

a) Oficerët me gradën nëntoger dhe toger e fitojnë të drejtën për të marrë gradën e radhës pas plotësimit të afatit kohor të qëndrimit në një gradë, të përcaktuar në nenin 11.

b) Oficerët dhe nënoficerët që kanë 12 vjet shërbim, me kërkesën e tyre, u lind e drejta të kalojnë profesionistë në varësi me nevojat e Forcave të Armatosura dhe të kualifikimit përkatës.

c) Koha maksimale e qëndrimit në gradën kapiten është 17 vjet vjetërsi si oficer, në gradën e majorit 20 vjet vjetërsi si oficer, në gradën e nënkolonelit 27 vjet vjetërsi si oficer, në gradën e kolonelit 30 vjet vjetërsi si oficer.

Nga pika "c" e këtij neni përjashtohen ushtarakët e përcaktuar në pikën 7 të nenit 11.

ç) Vjetërsia e ushtarakëve për çdo gradë llogaritet:

- kur plotëson kriteret për marrjen e gradës së radhës, nga dita kur i lind e drejta për marrjen e kësaj grade;

- kur nuk plotëson kriteret për marrjen e gradës së radhës, nga data e daljes së urdhrit për marrjen e gradës.

KREU III

KARRIERA USHTARAKE, KRITERET DHE MËNYRA E GRADIMIT

Neni 13

1. Gradat për ushtarët jepen nga komandanti i njësisë (brigadë-regjiment) dhe i reparteve të njësuar me të.

2. Gradat e nënoficerëve aktivë e rezervistë jepen nga komandanti i forcës dhe nga komandantët e njësisë të varësisë së Shtabit të Përgjithshëm, sipas kriterëve të përcaktuara.

3. Kursantët, që përfundojnë kurset pranë Akademisë së Nënoficerëve, titullohen nënoficerë dhe u jepet grada kapter V. Të drejtën e propozimit për titullimin e nënoficerëve dhe dhënien e gradës, në përfundimin e kursit, e ka komandanti i kësaj akademie.

Neni 14

1. Titullimi oficer aktiv dhe dhënia e gradës së parë të oficerit bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

2. Gradën nëntoger e marrin studentët që mbarojnë arsimin e lartë ushtarak, në akademitë ushtarake brenda ose jashtë vendit, të njësuar me to dhe titullohen oficerë aktivë.

3. Të drejtën e propozimit për titullimin oficer aktiv dhe dhënien e gradës nëntoger e ka titullari i institucionit të arsimit të lartë ushtarak.

4. Gradat ushtarake të oficerëve, nga nëntoger deri në kolonel, jepen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

5. Gradat madhore u jepen oficerëve me dekret të Presidentit të Republikës dhe me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

6. Gradat e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe, në kohë lufte, Komandantit të Forcave të Armatosura, u jepen me dekret të Presidentit të Republikës dhe me propozimin e Kryeministrit.

Neni 15

Oficerëve, që kryejnë detyra në prokuroritë dhe në gjykatat ushtarake ose në institucionet qendrore dhe në organet e qeverisjes vendore, gradat ushtarake deri në kolonel u jepen me urdhër të Ministrisë të Mbrojtjes dhe me propozimin e drejtuesit të institucionit qendror përkatës, kurse gradat madhore u jepen me dekret të Presidentit të Republikës dhe me propozimin e drejtuesit të institucionit qendror përkatës.

Neni 16

Gradat ushtarake për oficerët rezervë jepen në bazë të vjetërsisë në shërbim dhe të funksionit organik kur plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 17

1. Ushtarakut i lind e drejta për gradimin e radhës kur plotëson kriteret e mëposhtme:
 - a) afatin kohor të qëndrimit në një gradë, sipas nenit 11 të këtij ligji;
 - b) arsimimin dhe kualifikimin e nevojshëm në shkolla e kurse, ushtarake e civile;
 - c) rezultatet e vlerësimeve vjetore të punës.
2. Ushtarakët, për marrjen e çdo grade më të lartë se ajo që kanë, kanë të drejtë të shqyrtohen e të vlerësohen nga komisionet e gradave e të karrierës për çdo gradë si më poshtë:
 - a) nënoficerët vetëm 1 herë;
 - b) oficerët me gradën toger deri në kolonel (kapiten i rangut I) 2 herë;
 - c) oficerët me gradën gjeneral - brigade e lart vetëm 1 herë.

Neni 18

Ushtarakët e forcave tokësore, për të fituar gradën e radhës, duhet të plotësojnë kriteret e arsimimit dhe të kualifikimit si më poshtë:

1. Oficerët:
 - a) Toger, për të fituar gradën e kapitenit, të ketë kryer kursin e komandantit të kompanisë, kursin e oficerit të shtabit të batalionit në Akademinë e Forcave Tokësore ose kurse të njësuara me to jashtë vendit.
 - b) Kapiteni, për të fituar gradën e majorit, të ketë kryer kursin themelor të oficerit të shtabit në Akademinë e Mbrojtjes ose kurse të njësuara me të në akademitë ushtarake jashtë vendit.
 - c) Majori, për të fituar gradën e nënkolonelit, të ketë kryer kursin e Shtabit të Përgjithshëm ose kursin e funksioneve në shtab në Akademinë e Mbrojtjes ose kurse të njësuara me to në akademitë ushtarake jashtë vendit.
 - ç) Nënkoloneli, për të fituar gradën e kolonelit, të ketë kryer kursin e Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Mbrojtjes ose kurse të njësuara me të në akademitë ushtarake jashtë vendit.
 - d) Koloneli, për të fituar gradën madhore, përveç kursit të Shtabit të Përgjithshëm, të ketë kryer kursin e lartë në kolegjin e mbrojtjes pranë Akademisë së Mbrojtjes ose kurse, ose kolegje të larta jashtë vendit.
2. Nënoficerët:
 - a) Kapteri V deri në kapter IV, të ketë kryer kursin e përgatitjes së përgjithshme për nivelin e komandantit të skuadrës në Akademinë e Nënoficerëve.
 - b) Kapteri IV, për të fituar gradën kapter III, të ketë kryer kursin e përgatitjes së përgjithshme për nivelin e nënoficerit të togës në Akademinë e Nënoficerëve.
 - c) Kapteri III, për të fituar gradën kapter II, të ketë kryer kursin e thellimit të njohurive në Akademinë e Nënoficerëve.
 - ç) Kapteri II, për të fituar gradën kapter I, të ketë kryer kursin e nënoficerit të shtabit të batalionit për sektorin që do të shërbejë në shtab.

d) Kapteri I, për të fituar gradën kapter, të ketë kryer në Akademinë e Nënoficerëve kursin e nënoficerit të shtabit të brigadës për sektorin që do të shërbejë.

dh) Kapteri, për të fituar gradën kryekapter, të plotësojë kohën e qëndrimit në gradën që ka dhe të ketë rezultate të qëndrueshme në kryerjen e detyrës funksionale.

3. Ushtarët:

a) Ushtari, për të fituar gradën tetar, të ketë kryer periudhën e plotë të përgatitjes së përgjithshme (përshtatjen me jetën ushtarake) dhe atë individuale, të posaçme deri në skuadër, si dhe të jetë vlerësuar me mbi 80 për qind të pikëve të mundshme.

b) Tetari, për të fituar gradën rreshter III, të ketë kryer periudhën e plotë të kompaktësimit në togë dhe të jetë vlerësuar me mbi 80 për qind të pikëve të mundshme.

c) Rreshteri III, për të fituar gradën rreshter II, të ketë kryer periudhën e plotë të kompaktësimit të nënrepartit (kompani, bateri) dhe të jetë vlerësuar me mbi 80 për qind të pikëve të mundshme.

ç) Rreshteri II, për të fituar gradën rreshter I, zakonisht është ushtar me pagesë ose rezervist dhe të ketë kryer periudhën e plotë të kompaktësimit të veprimeve në përbërje të repartit (batalionit) dhe të ketë marrë mbi 80 për qind të pikëve të mundshme në vlerësim. Kjo gradë merret pas kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv sipas llojit të armës.

Neni 19

Ushtarakët e forcave ajrore, për të fituar gradën e radhës, të plotësojnë kriteret e arsimit dhe të kualifikimit si më poshtë:

1. Oficerët:

a) Togeri, për të fituar gradën e kapitenit, të ketë kryer kursin fillestar në Akademinë e Forcave Ajrore ose kursin e komandantit të kompanisë në Akademinë e Forcave Tokësore, kursin e oficerit të shtabit të batalionit ose kurse të tjera jashtë vendit të njësuara me to.

b) Kapiteni, për të fituar gradën e majorit, të ketë kryer kursin themelor të oficerit të shtabit në Akademinë e Mbrojtjes, ndërsa pilotët të kenë fituar edhe klasin III për fluturim.

c) Majori, për të fituar gradën e nënkolonelit, të ketë kryer kursin e Shtabit të Përgjithshëm ose kursin e funksioneve në shtab në Akademinë e Mbrojtjes, ndërsa pilotët të kenë fituar klasin II për fluturim dhe personeli inxhiniero-teknik të ketë kryer kursin e lartë profesional sipas specialiteteve në Akademinë e Forcave Ajrore.

ç) Nënkoloneli, për të fituar gradën e kolonelit, të ketë kryer kursin e Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Mbrojtjes ose kurse të njësuara me të në akademitë ushtarake jashtë vendit.

d) Koloneli, për të fituar gradë madhore, përveç kursit të Shtabit të Përgjithshëm, të ketë kryer kursin e lartë në kolegjin e mbrojtjes në Akademinë e Mbrojtjes ose kurse, ose kolegje të larta jashtë vendit.

2. Nënoficerët:

a) Kapteri V deri kapter II të forcave ajrore e fitojnë njëjloj si nënoficerët e forcave tokësore.

b) Kapteri I dhe kapter, përveç kriterëve si kapterët e forcave tokësore, të kenë fituar titullin "specialist i klasit II" në specialitetin përkatës.

c) Për të fituar gradën kryekapter, përveç kriterëve të mësipërme, të ketë fituar titullin "specialist i klasit I" në specialitetin përkatës.

3. Ushtarët:

a) Ushtari, për të fituar gradën tetar, të ketë kryer periudhën e plotë të përgatitjes së përgjithshme (përshtatjen me jetën ushtarake) dhe atë individuale, speciale deri në skuadër dhe të jetë vlerësuar me mbi 80 për qind të pikëve të mundshme.

b) Tetari, për të fituar gradën rreshter III, të ketë kryer periudhën e plotë të kompaktësimit në togë dhe të jetë vlerësuar me mbi 80 për qind të pikëve.

c) Rreshter III, për të fituar gradën rreshter II, të ketë kryer periudhën e plotë të

kompaktësimit të nënrepartit (kompani, bateri) dhe të jetë vlerësuar me mbi 80 për qind të pikëve.

ç) Rreshteri II, për të fituar gradën rreshter I, zakonisht është ushtar me pagesë ose rezervist, të ketë kryer periudhën e plotë të kompaktësimit të veprimeve në përbërje të repartit (batalionit) dhe të ketë marrë mbi 80 për qind të pikëve. Kjo gradë merret pas përfundimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak, sipas llojit të armës dhe të shërbimit.

Neni 20

Ushtarakët e forcave detare, për të fituar gradën e radhës, duhet të plotësojnë kriteret e arsimimit dhe të kualifikimit si më poshtë:

Oficerët:

a) Nënlejtanti, për të fituar gradën lejtant, të ketë kryer kursin e kualifikimit për zëvendëskomandant anijeje në Akademinë Detare, si dhe të ketë dhënë provimet për vetëdrejtim sipas funksionit organik.

b) Lejtanti, për të fituar gradën kapiten-lejtant, të ketë kryer kursin e kualifikimit për zëvendëskomandant anijeje, si dhe të ketë dhënë provimet për vetëdrejtim sipas funksionit organik (vetëdrejtimi i anijes).

c) Kapiteni-lejtanti, për të fituar gradën kapiten i rangut III, të ketë kryer kursin themelor të oficerit të shtabit në Akademinë e Mbrojtjes ose kursin e kualifikimit për oficer shtabi distrikti detar e komandant flotiljeje në Akademinë e Detarisë, si dhe të ketë dhënë provimet për vetëdrejtim sipas funksionit organik.

ç) Kapiteni i rangut III, për të fituar gradën kapiten i rangut II, të ketë kryer kursin e Shtabit të Përgjithshëm ose kursin e funksioneve në shtab në Akademinë e Mbrojtjes, si dhe të ketë dhënë provimet për vetëdrejtim sipas funksionit organik.

d) Kapiteni i rangut II, për të fituar gradën kapiten i rangut I, të ketë kryer kursin e Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Mbrojtjes ose kurse të njësuara me të në akademitë ushtarake jashtë vendit.

dh) Kapiteni i rangut I, për të fituar gradën madhore, përveç kursit të Shtabit të Përgjithshëm, të ketë kryer kursin e lartë në kolegjin e mbrojtjes në Akademinë e Mbrojtjes ose kurse, ose kolegje të larta ushtarake jashtë vendit.

Nënoficerët:

a) Kapteri V deri në kapter II e fitojnë gradën njëlloj si nënoficerët e forcave tokësore.

b) Kapteri I të ketë kryer kursin fillestar të kualifikimit të nënoficerëve pranë Akademisë së Detarisë.

c) Kapteri të ketë kryer kursin e avancuar të kualifikimit të nënoficerëve në Akademinë e Detarisë.

ç) Kryekapteri, përveç kurseve të mësipërme, të ketë kryer kurs të veçantë kualifikimi në specialitetin përkatës në Akademinë e Detarisë.

Ushtarë (detarë):

a) Ushtari (detari), për të fituar gradën tetar, të ketë kryer periudhën e plotë të përgatitjes së përgjithshme (përshtatjen me jetën ushtarake) dhe atë individuale, speciale, deri në skuadër dhe të jetë vlerësuar me mbi 80 për qind të pikëve të mundshme.

b) Tetari, për të fituar gradën rreshter III, të ketë kryer periudhën e plotë të kompaktësimit në togë dhe të jetë vlerësuar me mbi 80 për qind të pikëve.

c) Rreshteri III, për të fituar gradën rreshter II, të ketë kryer periudhën e plotë të kompaktësimit në nënrepart (kompani, bateri) dhe të jetë vlerësuar me mbi 80 për qind të pikëve.

ç) Rreshteri III, për të fituar gradën rreshter II, të ketë kryer periudhën e plotë të kompaktësimit në nënrepart (kompani, bateri) dhe të jetë vlerësuar me mbi 80 për qind të pikëve.

d) Rreshteri II, për të fituar gradën rreshter I, zakonisht është ushtar me pagesë ose rezervist, të ketë kryer periudhën e plotë të kompaktësimit të veprimeve, në përbërje të repartit (batalionit) dhe të ketë marrë mbi 80 për qind të pikëve në vlerësim. Kjo gradë merret pas kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak, sipas llojit të armës dhe shërbimit.

Neni 21

1. Oficerët, që kryejnë detyra në specialitet, si mjek, inxhinier, jurist, ekonomist-financier dhe funksione të tjera të ngjashme në Forcat e Armatosura, gradën deri major (kapiten I i rangut III) e fitojnë sipas vjetërsisë në shërbim dhe jo sipas kriterëve që përcaktojnë nenet 18, 19, 20 të këtij ligji.

2. Për të fituar grada të tjera të larta të kryejnë kurse kualifikimi sipas funksioneve organike, në akademitë ushtarake brenda ose jashtë vendit sipas profesionit dhe llojit të forcës ku shërben, ndërsa për të fituar grada madhore të kenë kryer Akademinë e Mbrojtjes ose akademi ushtarake jashtë vendit të njësuara me to.

3. Kur oficerët, e përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, kërkojnë të përparojnë në gradë e karrierë, sipas përcaktimeve të paragrafit të dytë të këtij neni, organet kompetente janë të detyruara t'u ofrojnë kurset e nevojshme të arsimimit dhe kualifikimit.

Neni 22

Gradimi i parakohshëm i ushtarakëve për gradën e radhës mund të bëhet, jo më parë se një vit nga plotësimi i afatit kohor të qëndrimit në një gradë, vetëm një herë gjatë karrierës ushtarake.

Neni 23

1. Autoritete kompetente për vlerësimin e përparimit të oficerëve në gradë dhe karrierë, si dhe për kualifikimin brenda dhe jashtë vendit, janë komisionet e karrierës.

2. Komisionet e karrierës janë:

a) Komisioni i veçantë në Ministrinë e Mbrojtjes, i cili vlerëson oficerët me gradë madhore.

b) Komisioni i lartë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe komandat e llojeve të forcave (shërbimeve), Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe Komanda e Logjistikës, të cilët vlerësojnë oficerët me gradë nga major deri kolonel.

c) Komisioni i zakonshëm në komandat e llojeve të forcave (shërbimeve), në Komandën e Doktrinës e të Stërvitjes në Komandën e Logjistikës, i cili vlerëson oficerët me gradë nga nëntoger deri kapiten dhe nënoficerët e karrierës.

3. Komisionet e karrierës në Ministrinë e Mbrojtjes krijohen nga Ministri i Mbrojtjes me propozim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Ndërsa komisionet në komandat e llojeve të forcave (shërbimeve) dhe komandat e tjera krijohen nga Ministri i Mbrojtjes me propozimin e komandantëve përkatës.

4. Përbërja e Komisioneve të Karrierës:

Komisioni i veçantë i karrierës përbëhet nga:

- Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Kryetar i Komisionit;

- një gjeneral major më i vjetri në gradë;

- tre gjeneralë brigade më të vjetër në gradë dhe për të njëjtën vjetërsi grade ata me moshë më të madhe.

Komisioni i lartë i karrierës përbëhet nga:

- një gjeneral major, si kryetar komisioni në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në komandat e forcave (shërbimeve), Komandën e Doktrinës së Stërvitjes dhe Komandën e Logjistikës;

- tre gjeneralë brigade nga specialitete të ndryshme;

- dy kolonelë më të vjetër në gradë;

- një nënkolonel.

Komisioni i zakonshëm i karrierës përbëhet nga:

- shefi i shtabit i llojit të forcës (shërbimit), kryetar;

- pesë kolonelë (kapitenë të rangut të parë) që i përkasin specialiteteve të ndryshme;

- një nënkolonel më i vjetri në gradë.

5. Funksionimi, detyrat dhe të drejtat e Komisionit të Karrierës përcaktohen me rregullore të miratuara nga Ministri i Mbrojtjes.

Nuk bëjnë pjesë në komisionet e karrierës:

- (a) Ministri dhe Zëvendësministri i Mbrojtjes
- (b) Shefi i Kabinetit të Ministrisë të Mbrojtjes
- (c) Këshilltari Ushtarak i Presidentit të Republikës
- (d) Këshilltari Ushtarak i Kryeministrit
- (dh) Oficerët e Shërbimit Informativ

6. Komisionet e gradave të karrierës i përfundojnë procedurat e punës së tyre në muajin qershor të çdo viti.

Neni 24

1. Njësimi i gradave me funksionet e larta në hierarkinë e komandimit të Forcave të Armatosura është:

- a) Gjeneral brigade, komandant brigade këmbësorie me aktivë.
- b) Gjeneral major zëvendës-shef i Shtabit të Përgjithshëm, komandant force.
- c) Gjeneral lejtant - gjeneral, shef i Shtabit të Përgjithshëm, komandant i Forcave të Armatosura në kohë lufte.

2. Njësimi i gradave me funksionet e tjera, që nuk përfshihen në paragrafin e parë të këtij neni, në të gjitha nivelet e hierarkisë së komandimit dhe të drejtimit të Forcave të Armatosura, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrisë të Mbrojtjes.

Neni 25

1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënieve ligjore të punës për periudhën sa zgjat arsyeja e ndërprerjes. Në mbarim të kësaj periudhe, ushtaraku rimerr funksionin e tij, me përjashtim të rastit kur dënohet me heqje lirie.

Ushtaraku pezullohet :

- a) kur ndaj tij fillon ndjekja penale dhe vendoset masa e sigurisë, arrest me burg, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata;
- b) për periudha studimi, më shumë se 6 muaj, të ndërmarra me nismën e vetë ushtarakut, por në lidhje me profesionin që ai ushtron.

3. Gjatë periudhës së pezullimit ushtaraku nuk paguhet. Në rastin e parashikuar në pikën 2 shkronja "a" të këtij neni, kur çështja penale pushohet ose kur, me vendim gjykate të formës së prerë deklarohet i pafajshëm, ushtarakut i jepet paga bazë e funksionit të tij, që nga çasti i pezullimit.

4. Periudha e kohës së pezullimit nga detyra njihet si vjetërsi grade dhe shërbimi në Forcat e Armatosura, kur pezullimi ndodh për rastin e parashikuar në pikën 2 shkronja "a" të këtij neni dhe çështja penale pushohet ose kur, me vendim gjykate të formës së prerë, deklarohet i pafajshëm, ndërsa për rastin e parashikuar në pikën 2 shkronja "b", periudha e pezullimit njihet vetëm për efekt të vjetërsisë së gradës.

5. Pezullimi i oficerit nga detyra bëhet me urdhër të Ministrisë të Mbrojtjes, ndërsa nënoficerit dhe ushtari me pagesë me urdhër të komandantit të forcës.

Neni 26

1. Ushtaraku del në rezervë kur:

- a) nuk përparon në gradë;
- b) bëhen ndryshime strukturore ose shkurtime në numrin e personelit të Forcave të Armatosura dhe sistemimi në një detyrë tjetër është i pamundur;
- c) ka plotësuar afatin e kontratës;

- ç) paraqet kërkesën e tij;
2. Oficerët dalin në rezervë me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.
3. Nënoficerët dhe ushtarët me pagesë dalin në rezervë me urdhër të komandantit të forcës.
4. Kur del në rezervë me kërkesë të tij, ushtaraku duhet të paraqesë kërkesën me shkrim tre muaj para daljes në rezervë.

Neni 27

1. Ushtaraku del në lirim kur:
 - a) ka plotësuar moshën për pension pleqërie;
 - b) është dënuar me burgim me vendim gjykate të formës së prerë;
 - c) bëhet i paaftë nga ana shëndetësore për shërbim ushtarak, deklaruar me vendim të Komisionit të Spitalit Qendror Ushtarak;
 - ç) paraqet kërkesën e tij;
 - d) konstatohet papërshtatshmëria me vendin e punës, sipas ligjit "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura".
2. Oficerët dalin në lirim me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.
Nënoficerët dhe ushtarët me pagesë dalin në lirim me urdhër të komandantit të forcës.
3. Kur del në lirim me kërkesën e tij, ushtaraku duhet ta paraqesë kërkesën me shkrim tre muaj para daljes në lirim.

Neni 28

1. Për të gjitha mosmarrëveshjet që lindin në procedurën e dhënies së gradave, uljen në gradë, nxjerrjen në rezervë ose lirim nga shërbimi ushtarak në Forcat e Armatosura, ushtaraku ka të drejtë të ankohet te Ministri i Mbrojtjes, brenda 30 ditëve. Për rishqyrtimin e ankesave Ministri i Mbrojtjes krijon një komision tjetër nga ai i parashikuar në nenin 23 dhe brenda 30 ditëve jepen përgjigjet përkatëse.
2. Kur mosmarrëveshja nuk zgjidhet, sipas paragrafit të parë të këtij neni, ushtarakut i lind e drejta, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit (përgjigjes), të ankohet në gjykatë.
3. Kur akti i shfuqizuar nga gjykata ka të bëjë me nxjerrjen në rezervë ose me lirimin e ushtarakut nga Forcat e Armatosura, ai ka të drejtë të rikthehet në detyrën e mëparshme ose në një detyrë tjetër të njëjtë me atë të mëparshmen.

Neni 29

Ushtarakët që dalin në lirim për efekt moshe, paaftësie shëndetësore, si dhe ata që dalin në rezervë gëzojnë të drejtën e mbajtjes së uniformës ushtarake dhe të gradës që kishin në çastin e daljes në lirim ose rezervë, si dhe përdorimin e saj vetëm në rastet e festave zyrtare dhe të ceremonive të ndryshme ushtarake.

Neni 30

1. Ushtarakët në rezervë rikthehen në shërbimin aktiv vetëm në rastet kur:
 - a) bëhen shtesa në numrin e personelit të Forcave të Armatosura;
 - b) bëhet mobilizimi i përgjithshëm ose i pjesshëm.
2. Në këto raste ata mbajnë gradën e fundit që kishin në çastin e daljes në rezervë.

Neni 31

Gradimet e radhës bëhen një herë në vit në muajin shtator.

Neni 32

Forma dhe ndërtimi i gradave ushtarake caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 33

Në rastet e riorganizimit strukturor të Forcave të Armatosura, për mungesë funksioni organik që nuk përputhet me gradën që mban ushtaraku, me pëlqimin e ushtarakut, atij i krijohet mundësia e kryerjes së shërbimit në një funksion më të ulët duke mbajtur gradën që ka, por jo më shumë se 3 vjet.

**KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 34

1. Oficerët që mbajnë gradën kapiten I dhe, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, plotësojnë kriteret për fitimin e një grade më të lartë, gradohen major. Të tjerët mbajnë gradën kapiten I deri në testimin e radhës.

2. Përputhja e gradave me funksionet, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të përfundojë brenda vitit 2003.

Neni 35

Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Mbrojtjes të nxjerrin aktet e nevojshme në zbatim të këtij ligji brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi.

Neni 36

Ligji nr.7750, datë 13.9.1993 "Për gradat në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", nenet 16, 28, 29, 30, 31, 32 të ligjit nr.7978, datë 26.7.1995 "Për Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë", si dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor që bien në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 37

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2792, datë 17.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

**L I G J
Nr.8671, datë 26.10.2000**

**PËR PUSHTETET DHE AUTORITETET E KOMANDIMIT E TË DREJTIMIT
STRATEGJIK TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 169 pika 4 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I :

Neni 1

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i pushteteve dhe i autoriteteve të komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kuptimit të këtij ligji:

"Pushtet" është zotërimi i së drejtës të komandimit dhe të drejtimit mbi të tjerët, sipas ligjit. Pushteti nënkupton edhe institucionin ose personin, që e gëzon këtë të drejtë.

"Autoritet" është e drejta e ushtrimit të pushtetit, të dhënë me ligj ose të deleguar. Autoriteti nënkupton edhe institucionin ose individin që e gëzon këtë të drejtë.

"Komandim" nënkupton autoritetin që i jepet me ligj një individ të Forcave të Armatosura për udhëheqjen, komandimin dhe drejtimin e forcës ushtarake.

"Komandim i plotë" nënkupton autoritetin ushtarak dhe përgjegjësinë e eprorit për t'u dhënë urdhëra vartësve. Ky përfshin të gjitha aspektet ushtarake dhe administrative.

"Komandim operacional" nënkupton autoritetin që i jepet komandantit për t'u dhënë detyra e për t'u caktuar misionet komandantëve vartës, për të shpërndarë forcat dhe për të dhënë ose për të deleguar drejtimin operacional, sipas nevojës. Nuk përfshin përgjegjësinë administrative dhe logjistike.

"Drejtim" nënkupton autoritetin që ushtrohet mbi një pjesë të veprimtarive të organizmave në vartësi ose të dhëna në vartësi. I gjithë ose pjesë e këtij autoriteti mund të transferohet ose të delegohet, në përputhje me këtë ligj dhe me akte të tjera ligjore e nënligjore.

"Drejtim operacional" nënkupton autoritetin që i jepet një komandant për të drejtuar forcat e dhëna, për të plotësuar një mision a detyrë të veçantë, të kufizuar në detyra, kohë e vend. Ky nuk përfshin autoritetin për ta përdorur të ndarë forcën e dhënë dhe as drejtimin administrativ e logjistik.

"Veprimi (operacioni)" është kryerja e një misioni ushtarak strategjik, operativ, taktik, përgatitor, mbështetjeje, shërbimi, administrativ dhe njerëzor.

"Plani i veprimeve" është plani për një ose disa veprime, të lidhura me njëri-tjetrin, që zbatohen njëherësh apo njëri pas tjetrit. Përgatitet sipas një parashikimi dhe ka formën e një udhëzimi, që autoriteti më i lartë e lëshon për komandantët vartës, në mënyrë që këta të fundit të përgatisin planet mbështetëse dhe urdhërat. Nëse plani zbatohet në një kohë të caktuar, atëherë ai kthehet në urdhër luftimi.

"Urdhri" është një kumtim i shkruar, i dhënë me gojë ose edhe me sinjal, i cili përmban detyrat dhe udhëzimet e eprorit për vartësin.

"Delegim autoriteti" nënkupton aktin nëpërmjet të cilit personi i njohur me ligj si autoritet i ngarkon një pjesë të autoritetit (përgjegjësi) të vet një vartësi, në raport të drejtë me detyrën që ai ka. Shtrirja e autoritetit të deleguar duhet të shprehet qartë dhe pa dykuptime ose keqkuptime.

"Shërbim" nënkupton njërin nga përbërësit e Forcave të Armatosura (forca tokësore, detare dhe ajrore).

"Shef shërbimi" është autoriteti përgjegjës për doktrinën, zhvillimin, planet, programet dhe menaxhimin e personelit në shërbimin e vet. Është i njësuar me komandant force (tokësore, detare dhe ajrore).

"Forcë ushtarake" nënkupton :

a) një shërbim të Forcave të Armatosura;

b) një njësi ushtarake, të pajisur, të përgatitur e të gatshme të përdorë forcën.

"Burimet" nënkuptojnë njerëzit, financat dhe të gjitha mjetet e tjera materiale, që u jepen forcave për t'u përgatitur dhe për të luftuar.

KREU I
PUSHTETET DHE AUTORITETET E KOMANDIMIT
DHE TË DREJTIMIT STRATEGJIK

Neni 3

Pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe të drejtimit strategjik për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë :

Kuvendi
Presidenti i Republikës
Këshilli i Ministrave
Kryeministri
Ministri i Mbrojtjes
Shtabi i Përgjithshëm
Shefi i Shtabit të Përgjithshëm
Komandantët e forcave (tokësore, detare dhe ajrore).

Neni 4
Kuvendi

1. Miraton me ligj dokumentin e strategjisë së sigurimit dhe dokumentin e politikës së mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe ligjet e tjera në fushën e mbrojtjes e të Forcave të Armatosura.

2. Miraton buxhetin e mbrojtjes.

3. Miraton numrin limit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe misionin e tyre.

4. Ushtron kontroll parlamentar mbi veprimtaritë që kanë lidhje me Forcat e Armatosura.

5. Vendos për dërgimin dhe përdorimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

6. Lejon, me ligj, vendosjen e forcave të huaja ushtarake në territorin e Republikës së Shqipërisë ose kalimin e tyre nëpër territorin shqiptar, duke përcaktuar dhe statusin e tyre.

7. Ratifikon dhe denoncon, me ligj, traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me territorin, paqen, aleancat, çështjet politike e ushtarake, si dhe me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare.

8. Kuvendi, në rast kërcënimesh të jashtme ose kur detyrimi për mbrojtje të përbashkët buron nga një marrëveshje ndërkombëtare, me propozimin e Presidentit të Republikës, shpall gjendjen e luftës, vendos gjendjen e mobilizimit dhe të çmobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm të vendit dhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

9. Kuvendi deklaron përfundimin e luftës dhe shpall paqen.

10. Shpall, me kërkesën e Këshillit të Ministrave, gjendjen e jashtëzakonshme në rast rreziku për rendin kushtetues dhe për sigurinë publike, si dhe në raste fatkeqësish natyrore, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose në pjesë të veçanta të tij, si dhe përcakton detyrimet dhe kufizimet gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.

11. Vendos, me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, për përdorimin e Forcave të Armatosura në rivendosjen e rendit, vetëm kur forcat e policisë nuk janë në gjendje ta kryejnë këtë detyrë.

12. Përcakton pushtetet dhe autoritetin e komandimit e të drejtimit të Forcave të Armatosura për kohë paqeje, gjendje të jashtëzakonshme dhe kohë lufte.

KREU II PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Neni 5

Presidenti i Republikës është Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Presidenti i Republikës, në kohë paqeje e ushtron drejtimin e Forcave të Armatosura nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes, ndërsa në kohë lufte i drejton Forcat e Armatosura drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet Komandantit të Forcave të Armatosura.

Neni 6

Në rast të një sulmi të armatosur kundër Republikës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës, me kërkesën e Këshillit të Ministrave, shpall gjendjen e luftës.

Dekretin për vendosjen e gjendjes së luftës, Presidenti ia paraqet Kuvendit brenda 48 orëve nga nënshkrimi, duke përcaktuar qartë të drejtat që kufizohen.

Neni 7

Presidenti i Republikës, si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, gëzon autoritetin e plotë të komandimit e të drejtimit të Forcave të Armatosura dhe ka këto detyra e përgjegjësi:

1. Miraton, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, strukturën organizative të Forcave të Armatosura.
2. Miraton planin e veprimeve të Forcave të Armatosura në kohë paqeje dhe në rastet e vendosjes së masave të jashtëzakonshme.
3. Miraton shpërndarjen e Forcave të Armatosura në kohë paqeje dhe vendos për mobilizimin dhe për provat e gatishmërisë së njësive ushtarake rezervë, brigadë e lart.
4. Në kohë lufte, emëron e shkarkon, me propozimin e Kryeministrit, Komandantin e Forcave të Armatosura.
5. Emëron e shkarkon, me propozimin e Kryeministrit, Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
6. Emëron e shkarkon, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, komandantët e forcave tokësore, detare dhe ajrore.
7. Jep gradën e gjeneralit dhe dekoron ushtarakët e Forcave të Armatosura.
8. Emëron, shkarkon dhe nxjerr në rezervë ose në lirim, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, oficerët me grada madhore.
9. Urdhëron fillimin e veprimeve luftarake, kur shkelet integriteti i hapësirave tokësore, ajrore e detare të Republikës së Shqipërisë.
10. Miraton vendimet e Komandantit të Forcave të Armatosura për përdorimin në veprimet ushtarake në kohë lufte të Forcave të Armatosura.
11. I propozon Kuvendit përfundimin e gjendjes së luftës dhe ndërkohë përcakton mënyrën e zhvillimit të bisedimeve për paqe.
12. Urdhëron vendosjen e shkallëve të ndryshme të gatishmërisë luftarake të Forcave të Armatosura, në kushtet e masave të jashtëzakonshme.
13. Urdhëron lëvizjen, rivendosjen dhe përdorimin e Forcave të Armatosura, në kushtet e masave të jashtëzakonshme.
14. Deleton autoritetin e komandimit operacional të njësive ushtarake, të madhësisë ushtarskuadër-togë-kompani-batalion të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë te komandat aleate, me të cilat forcat tona kryejnë misione e veprime të përbashkëta, sipas marrëveshjeve dhe traktateve të ratifikuara nga Kuvendi.

15. Miraton regjimin, rregullat e gatishmërisë luftarake dhe ngritjen në kushtim të Forcave të Armatosura.

16. U jep njësitë ushtarake, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, flamujt luftarakë.

Neni 8

Presidenti i Republikës, si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, nxjerr urdhëra dhe udhëzime në ushtrimin e detyrave dhe të përgjegjësisë që ka.

Neni 9

Presidenti i Republikës i rekomandon Këshillit të Ministrave ndryshime në buxhetin për mbrojtjen, në varësi të nevojave për:

- përballimin e rreziqeve, që i kanosen Republikës së Shqipërisë ose përballimin e gjendjes së luftës;
- përballimin e gjendjeve që mund të krijohen në Forcat e Armatosura;
- krijimin e njësitë të reja ushtarake në Forcat e Armatosura;
- programe të veçanta për zhvillimin dhe modernizimin e Forcave të Armatosura.

Neni 10

Për marrjen e vendimeve të rëndësishme që ka në përgjegjësi, Presidenti këshillohet me Këshillin e Sigurimit Kombëtar.

Neni 11

Këshilli i Sigurimit Kombëtar është organ këshillimor pranë Presidentit të Republikës.

Neni 12

Këshilli i Sigurimit Kombëtar ushtron veprimtarinë në bazë të Kushtetutës dhe të ligjeve e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi.

Neni 13

1. Këshilli i Sigurimit Kombëtar thirret nga Presidenti i Republikës, sipas një renditjeje të përcaktuar.

2. Këshilli i Sigurimit Kombëtar ndihmon Presidentin e Republikës në çështje të sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit, si dhe të drejtimit, organizimit dhe mobilizimit të burimeve njerëzore dhe materiale, në dobi të sigurisë e të mbrojtjes së vendit.

3. Këshilli i Sigurimit Kombëtar diskuton dhe jep mendime për çështje të politikës së sigurimit, të politikës së mbrojtjes, të armëkontrollit dhe për të gjitha çështjet e sigurisë e të mbrojtjes.

4. Këshilli i Sigurimit Kombëtar nuk merr vendime. Mbledhjet e tij, si rregull, zhvillohen të mbyllura.

5. Anëtarë të Këshillit të Sigurimit Kombëtar janë: Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Rendit Publik, Ministri i Pushtetit Lokal, Ministri i Financave, Ministri i Transportit, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror.

Presidenti, sipas çështjeve që diskutohen, mund të ftojë në mbledhje edhe persona të tjerë si kryetarë të komisioneve të përhershme parlamentare, ministra, drejtues të institucioneve qendrore shtetërore etj.

KREU III KËSHILLI I MINISTRAVE

Neni 14

Këshilli i Ministrave ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Përgatit dhe i paraqet për miratim Kuvendit projektligjet për mbrojtjen dhe dokumentin e strategjisë së sigurimit dhe dokumentin e politikës së mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, si dhe zbatimin e tyre në kohë paqeje.
2. I propozon Kuvendit ndryshime në numrin limit të personelit të Forcave të Armatosura.
3. Miraton, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, planin e mobilizimit të përgjithshëm për kohë lufte të burimeve njerëzore dhe atyre materialofinanciare të vendit.
4. Paraqet në Kuvend buxhetin e mbrojtjes dhe programet e veçanta financiare për Forcat e Armatosura për kohë paqeje dhe lufte.
5. Drejton veprimtarinë e organeve të pushtetit qendror e të qarqeve, si dhe bashkërendon punën me organet e tjera të qeverisjes vendore për mobilizimin e pjesshëm dhe të përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe të burimeve për luftë.
6. Përcakton pagat dhe trajtimin ekonomik të personelit ushtarak (të oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve me pagesë) dhe të personelit civil, që shërben në Forcat e Armatosura.
7. Përcakton afatet e shërbimit dhe të përdorimit të armëve, të teknikës dhe të pajisjeve të Forcave të Armatosura, rregullat për trajtimin e tyre pas heqjes nga armatimi dhe përdorimi. Procedurat dhe përgjegjësitë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
8. Drejton dhe bashkëpunon me organet e qeverisjes vendore për rekrutimin e shtetasve, për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, aktiv dhe në rezervë.
9. Organizon dhe drejton mbrojtjen civile të Republikës së Shqipërisë dhe vendos krijimin dhe funksionimin e shtabeve të mbrojtjes pranë qarqeve, në të gjithë territorin e vendit.
Organizon shërbimin e kërkim-shpëtimit në shkallë vendi.
11. Nxjerr akte nënligjore për mbrojtjen dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
12. I kërkon Kuvendit të vendosë në një pjesë ose në të gjithë territorin e shtetit gjendjen e jashtëzakonshme në rast rreziku për rendin kushtetues dhe për sigurinë publike.
13. I kërkon Kuvendit, me vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme, ndërhyrjen e Forcave të Armatosura për rivendosjen e rendit, vetëm kur forcat e policisë nuk janë në gjendje ta kryejnë këtë detyrë.
14. Vendos për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e vendit, duke përcaktuar edhe masat që duhen marrë.
15. Miraton programe të veçanta për pajisjen dhe modernizimin e Forcave të Armatosura.
16. Miraton uniformën ushtarake, gradat dhe shenjat që mbahen në uniformën ushtarake.

KREU IV KRYEMINISTRI

Neni 15

Kryeministri është përgjegjës para Kuvendit dhe Presidentit të Republikës për drejtimin dhe gjendjen e Forcave të Armatosura në kohë paqeje.

Neni 16

Kryeministri ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1. I propozon Presidentit të Republikës emërimin dhe shkarkimin e komandantit të Forcave të Armatosura në kohë lufte.

2. I propozon Presidentit të Republikës emërimin dhe shkarkimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

3. I propozon Presidentit të Republikës gradimin, uljen në gradë, si dhe nxjerrjen, në rezervë a në lirim, të ushtarakëve me gradë madhore në Forcat e Armatosura, të përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Urdhëron përdorimin e Forcave të Armatosura për parandalimin, mënjanimin ose zhdukjen e pasojave të një fatkeqësie natyrore ose njerëzore.

5. Emëron dhe shkarkon, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, drejtorët e drejtorive në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm, me përjashtim të atyre që mbajnë gradën e gjeneralit.

6. Miraton strukturën organizative të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm.

7. Miraton listën e aerodromeve ushtarake, që mund të caktohen si aeroporte rezervë të aviacionit civil.

8. Bashkërendon dhe kontrollon veprimtarinë e institucioneve që kanë detyrime në zbatim të ligjit "Për miratimin e dokumentit të strategjisë së sigurimit të Republikës së Shqipërisë".

9. Bashkërendon punën ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Transportit për kontrollin e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë.

10. Bashkërendon punën ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal për lajmërimin e popullsisë për rreziqet e fatkeqësisë natyrore, të aksidentit teknologjik dhe për rreziqet e luftës.

Drejton sistemin e mbrojtjes civile dhe të kërkimshpëtimit.

KREU V MINISTRI I MBROJTJES

Neni 17

Ministri i Mbrojtjes përgjigjet para Kuvendit, Presidentit dhe Kryeministrit për zbatimin e politikës së mbrojtjes.

Neni 18

Ministri i Mbrojtjes është person civil.

Neni 19

Ministri i Mbrojtjes ka këto detyra e përgjegjësi:

1. I paraqet Këshillit të Ministrave projektin e dokumentit të politikës së mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe projektet që kanë të bëjnë me numrin, strukturën dhe organizimin e Forcave të Armatosura.

2. Nxjerr urdhëra, rregullore e udhëzime për Forcat e Armatosura, brenda detyrave dhe përgjegjësi që ka.

3. Përfaqëson shtetin në organizmat ndërkombëtarë për çështjet e mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura.

4. Paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave buxhetin vjetor të mbrojtjes, planet afatgjata të zhvillimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura dhe programet e veçanta në fushën e mbrojtjes, që kërkojnë mbështetje financiare.

Miraton shpërndarjen e buxhetit të mbrojtjes.

6. Miraton organikën analitike të Ministrisë së Mbrojtjes, të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Forcave të Armatosura, brenda numrit limit të përcaktuar. Miraton tabelat e organizimit dhe të pajisjeve të njësiive ushtarake.

7. Emëron dhe thërret atashetë ushtarakë pranë përfaqësive diplomatike të Republikës së

Shqipërisë.

8. Gradon dhe ul në gradë, vetëm një shkallë, ushtarakët deri në “kolonel” dhe “kapiten i rangut të parë”.

9. Propozon dhënien e gradave madhore, emërimin dhe lirimn nga detyra të oficerëve madhorë të Forcave të Armatosura.

10. Emëron dhe shkarkon oficerët që shërbejnë në institucionet shtetërore civile, duke marrë edhe pëlqimin e titullarit të institucionit.

11. Paraqet në Këshillin e Ministrave modelin e uniformës ushtarake, të gradave dhe të shenjave që vendosen në uniformë.

12. I paraqet Presidentit të Republikës njësitë e Forcave të Armatosura, të cilat do të mbajnë flamuj luftarakë.

13. Jep titullin e parë - oficer në Forcat e Armatosura. Emëron e shkarkon nga detyra, nxjerr në rezervë dhe liron nga shërbimi ushtarak oficerët e Forcave të Armatosura me përjashtim të ushtarakëve që janë të emërtesave të tjera.

14. Komandon oficerët e Forcave të Armatosura në një detyrë tjetër për një periudhë kohe jo më shumë se 6 muaj.

15. Lidh marrëveshje ndërkombëtare, me karakter shkencor, kulturor, arsimor, teknik etj., brenda kuadrit të fushës dhe të juridiksionit të tij, si dhe nënshkruan marrëveshje me karakter ushtarak në kohë paqeje, kur plotëfuqia për nënshkrim i lëshohet nga autoritetet përgjegjëse.

16. I propozon Presidentit të Republikës dhënien e medaljeve, të urdhërave dhe të titujve të nderit për personelin ushtarak e civil të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes.

17. Shfuqizon ose ndryshon aktet e nxjerra nga titullarët e njësive, të institucioneve dhe të ndërmarrjeve ushtarake, që varen prej tij.

18. Deleton autoritetin e drejtimit operacional të njësive ushtarake, ushtar-skuadër-togë-kompani-batalion, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë te komandat aleate, me të cilat forcat tona kryejnë misione të përbashkëta, sipas marrëveshjeve dhe traktateve të miratuara me ligj nga Kuvendi.

19. Organizon sistemin e mbrojtjes së informacionit të klasifikuar në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

20. Jep stimujt, medalionet, simbolet a shenjat, që mbajnë njësitë ushtarake dhe ushtarakët, si dhe përcakton rregullat e dhënies së tyre.

Ministri i Mbrojtjes, përveç përgjegjësive të përcaktuara në këtë ligj, ushtron dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara me ligje të veçanta.

Neni 20

Pranë Ministrit të Mbrojtjes krijohet këshilli i politikës së mbrojtjes si organ këshillimor. Anëtarë të këtij këshilli janë: Zëvendësministri i Mbrojtjes, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm, komandantët e forcave tokësore, detare dhe ajrore, Komandanti i Stërviçjes dhe Doktrinave, Komandanti i Mbështetjes Logjistike, Drejtori i Drejtorisë Juridike, si dhe persona të tjerë të ftuar nga Ministri.

Neni 21

Në kohë paqeje Ministri i Mbrojtjes është eprori më i lartë i të gjithë personelit ushtarak e civil të Forcave të Armatosura.

Neni 22

Zëvendësministri i Mbrojtjes është ndihmësi i drejtpërdrejtë i Ministrit të Mbrojtjes. Në mungesë dhe me porosi të Ministrit ai vepron sipas përgjegjësive që i delegohen.

KREU VI SHTABI I PËRGJITHSHËM

Neni 23

Shtabi i Përgjithshëm përbën strukturën organizative më të lartë ushtarake në Forcat e Armatosura dhe kryen komandën unike në Forcat e Armatosura. Ai është përgjegjës për krijimin e një force luftarake të përbashkët e të njësuar, me forcat tokësore, detare dhe ajrore, të aftë për të plotësuar misionin e vet kushtetues.

Neni 24

Shtabi i Përgjithshëm vepron si shtab i bashkuar i forcave tokësore, detare dhe ajrore dhe përgjigjet për:

- përgatitjen dhe stërvitjen e përbashkët të të tria shërbimeve për tërë detyrat e tyre, për të përballuar kërcënimet a rreziqet që kërcënojnë sigurinë në vend;
- planifikimin dhe programimin e mbrojtjes; vlerësimin strategjik të kërcënimeve a të rreziqeve dhe marrjen e masave për përballimin e tyre;
- përgatitjen dhe drejtimin e veprimeve ushtarake dhe drejtimin e Forcave të Armatosura në këto veprime;
- mbështetjen logjistike;
- planifikimin dhe rekrutimin e personelit ushtarak;
- hartimin e kërkesave për zhvillimin dhe pajisjen e tri shërbimeve të Forcave të Armatosura;
- përdorimin e frytshëm të burimeve të mbrojtjes dhe menaxhimin e burimeve financiare;
- planifikimin, përgatitjen, stërvitjen e pajisjen e forcave, për t'i bërë të ndërveprueshme dhe të afta për veprime ndërkombëtare;
- zhvillimin e sistemeve të komandimit, të drejtimit, të komunikimit e të njoftimit të të dhënave në Forcat e Armatosura dhe të infrastrukturave ushtarake.

Neni 25

Shtabi i Përgjithshëm plotësohet me oficerë të forcave tokësore, detare dhe ajrore, në përputhje me përqindjen që zë secila forcë në numrin e përgjithshme të Forcave të Armatosura.

Neni 26

Në kohë lufte, Shtabi i Përgjithshëm vepron si komandë e Forcave të Armatosura. Përgjegjësitë e Shtabit si komandë e Forcave të Armatosura dhe të komandantit të Forcave të Armatosura për kohë lufte caktohen me ligj të veçantë.

KREU VII SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM

Neni 27

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm është përgjegjës përpara Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes për përgatitjen dhe gatishmërinë luftarake të Forcave të Armatosura, për plotësimin me personel, si dhe për drejtimin dhe organizimin e veprimeve ushtarake dhe joushtarake.

Neni 28

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm është këshilltari më i lartë ushtarak i Presidentit të Republikës, i Kryeministrit dhe i Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 29

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm është ushtaraku më i lartë, në gradë e detyrë, në Republikën e Shqipërisë dhe eprori më i lartë ushtarak i të gjithë personelit të Forcave të Armatosura.

Neni 30

1. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm emërohet me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Kryeministrit. Ai zgjidhet nga radhët e oficerëve me grada madhore të Forcave të Armatosura, në bazë të aftësive profesionale dhe të përvojës.

2. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm bën betimin para Presidentit të Republikës. Formula e betimit është: “Beto hem se do t’i bindem Kushtetutës e ligjeve, do t’i shërbej me ndershmëri vendit tim dhe do të mbroj interesat e Republikës së Shqipërisë.”.

3. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm caktohet në këtë detyrë për një afat 3 vjeçar me të drejtë riemërimi.

Ai mund të lirohet nga detyra vetëm në rastet kur:

a) plotëson afatin e qëndrimit në detyrë;

b) jep dorëheqjen;

c) shkel Kushtetutën ose për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të detyrës;

ç) është i paaftë nga ana shëndetësore për një periudhë kohe mbi 6 muaj;

d) mbush moshën për pension pleqërie;

dh) kryen akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

4. Në rastet e lirimit nga detyra, sipas shkronjave “a”, “b”, “ç” të pikës 3 të këtij neni, ai përfiton trajtim të veçantë. Kriteret dhe masa e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Për rastet e shkronjave "c" dhe "dh" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk përfiton trajtim sipas pikës 4 të këtij neni.

Neni 31

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm drejton Shtabin e Përgjithshëm dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi:

Miraton doktrinat ushtarake të forcave tokësore, detare dhe ajrore.

Miraton planet e veprimeve të njësive ushtarake të të tria shërbimeve: tokësore, detare dhe ajrore, për kohë paqeje.

Paraqet te Ministri i Mbrojtjes projektin për strukturën, numrin dhe organizimin e Forcave të Armatosura.

I propozon Ministri të Mbrojtjes:

- planet afatgjata të zhvillimit dhe të modernizimit të Forcave të Armatosura dhe programet e veçanta në fushën e mbrojtjes, që kërkojnë mbështetje financiare;
- shpërndarjen e buxhetit të Forcave të Armatosura;
- tabelat e organizimit e të pajisjeve të njësive ushtarake;
- listën e njësive ushtarake që do të mbajnë flamuj luftarakë;
- modelin e uniformës ushtarake, të gradave dhe të shenjave në uniformën ushtarake.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm përfaqëson Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në organizmat ushtarakë ndërkombëtarë.

Jep stimuj, medalione e shenja sipas përgjegjësive që i janë caktuar nga Ministri i Mbrojtjes.

Neni 32

Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm është ndihmësi i drejtpërdrejtë i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Ai zgjidhet nga radhët e ushtarakëve me gradë madhore.

Neni 33

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm jep urdhëra dhe udhëzime të karakterit ushtarako-administrativ brenda kompetencave të tij.

KREU VIII KOMANDANTI I FORCËS

Neni 34

Komandimi dhe drejtimi i drejtpërdrejtë i forcave tokësore, detare e ajrore realizohet nga komandanti i secilës forcë.

Neni 35

1. Komandanti i forcës përgjigjet për gjendjen, përgatitjen, mobilizimin, gatishmërinë luftarake, drejtimin operacional për zhvillimin e doktrinës, të parimeve të operacioneve, të planifikimit e të programimit dhe të pajisjes e të modernizimit të forcës.

2. Komandanti i forcës jep urdhëra dhe udhëzime të karakterit ushtarako-administrativ brenda kompetencave të tij.

Neni 36

Komandanti i forcës (shefi i shërbimit) është këshilltari më i lartë kryesor ushtarak i Ministrisë së Mbrojtjes dhe i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm për forcën që drejton. Komandanti i forcës raporton edhe drejtpërdrejt te Ministri i Mbrojtjes.

Neni 37

Komandanti i forcës (shefi i shërbimit) ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Paraqet te Shefi i Shtabit të Përgjithshëm doktrinën e forcës që drejton.
- Miraton manualin e luftimit dhe të teknikës për forcën që drejton.
- Paraqet planet afatgjata dhe programet vjetore për forcën që drejton.
- Paraqet planin e veprimeve të forcave nën komandë për kohë paqeje, gjendje të jashtëzakonshme dhe për gjendje lufte.
- Paraqet projektet për strukturën e forcës që drejton dhe propozon ndryshimet e mundshme.
- Paraqet projektbuxhetin vjetor të forcës.
- Paraqet projektprogramet e përgatitjes dhe për kualifikimin e personelit brenda dhe jashtë vendit.
- Paraqet propozime për dekorime.
- Jep stimuj, medalione e shenja për vartësit, sipas rregulloreve të përcaktuara.
- Propozon dekorimin dhe gradimin jashtë radhe të personelit vartës.

Neni 38

Detyrat dhe përgjegjësitë e komandantëve, në nivel brigade deri në nivel toge, përcaktohen me rregullore të veçanta.

**KREU IX
PREFEKTI**

Neni 39

Prefekti, me cilësinë e tij si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në qark, përgjigjet për organizimin e mbrojtjes së popullsisë dhe të pronës nga fatkeqësitë natyrore, ekologjike dhe nga dëmtimet e luftës.

Neni 40

Prefekti përgjigjet për organizimin dhe realizon mobilizimin e përgjithshëm të burimeve për luftë dhe për përballimin e gjendjeve të fatkeqësive, si dhe rekrutimin e shtetasve për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak dhe lajmërimin e rezervistëve në rast kushtrimi luftarak dhe stërvitjeje.

Neni 41

Prefekti bashkëpunon me Forcat e Armatosura që veprojnë në qarkun e tij për mbrojtjen e popullsisë, për evakuimin, për shërbimin shëndetësor, për mbrojtjen nga zjarri, si dhe për përballimin e gjendjes në raste fatkeqësish të ndryshme.

Neni 42

Prefekti i propozon këshillit të qarkut nxjerrjen e urdhëresave e të vendimeve me fuqi detyruese për qarkun, për çështjet e organizimit të mbrojtjes së popullsisë dhe të plotësimit të detyrimeve të tjera ndaj nevojave të luftës dhe të përballimit të gjendjes së shkaktuar nga fatkeqësitë.

Neni 43

Ligji nr.8467, datë 31.3.1999 “Për kompetencat e Presidentit të Republikës si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe i Këshillit të Sigurimit Kombëtar” dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 44

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2793, datë 17.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

L I G J
Nr. 8677, datë 2.11.2000

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E POLICISË GJYQËSORE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton rregullat e atribuimit të funksioneve të policisë gjyqësore, të funksionimit të shërbimeve dhe seksioneve të policisë gjyqësore.

Neni 2
Bazat juridike të organizimit dhe funksionimit të
policisë gjyqësore

Organizimi dhe funksionimi i policisë gjyqësore mbështetet në dispozitat e Kushtetutës, të Kodit të Procedurës Penale, të Kodit Penal, të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, në dispozitat e këtij ligji dhe në ato të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e policisë gjyqësore.

Neni 3
Detyrat e policisë gjyqësore

Policia gjyqësore është subjekt i procedimit penal që ka për detyrë kryesore të marrë dijeni për veprat penale, të parandalojë pasojat e mëtejshme për shkak të tyre, të kryejë veprime hetimore të plota e të gjithanshme, kryesisht ose me urdhërim a delegim, për zbulimin e autorëve dhe për sigurimin e provave për veprimtarinë e tyre kriminale, si dhe detyra të tjera të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe në dispozita të tjera ligjore, me qëllim zbatimin e ligjit penal.

Neni 4
Varësia e policisë gjyqësore

1. Në ushtrimin e detyrave dhe të funksioneve të saj, policia gjyqësore është në varësi dhe drejtohet e kontrollohet nga prokurori.

2. Gjykata ngarkon dhe urdhëron policinë gjyqësore për kryerjen e detyrave procedurale nëpërmjet prokurorit.

3. Oficeri dhe agjenti i policisë gjyqësore është i detyruar të përmbushë në çdo rast detyrimet që lidhen me funksionin e policisë gjyqësore edhe në rastet si vijon:

- a) kur nuk shërben në një shërbim të policisë gjyqësore;
- b) pavarësisht nga territori dhe rrethana ku ndodhet;

c) gjendet jashtë kohës së kryerjes së shërbimit.

Neni 5

Ushtrimi i funksionit të policisë gjyqësore

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit, në rolin e lartë ose të mesëm, ushtron funksionin e oficerit të policisë gjyqësore, ndërsa ai i rolit bazë ushtron funksionin e agjentit të policisë gjyqësore. Punonjësi i Policisë së Shtetit i rolit madhor nuk ushtron funksione të policisë gjyqësore.

2. Oficeri dhe agjenti i forcave të tjera policore dhe i institucioneve publike ushtron përkatësisht funksionin e oficerit ose agjentit të policisë gjyqësore nëse ligji u njeh një funksion të tillë dhe mënyrën e parashikuar prej tij.

KREU II

SHËRBIMET E POLICISË GJYQËSORE

Neni 6

Shërbimet e Policisë Gjyqësore

1. Në kuptim të nenit 31 të Kodit të Procedurës Penale, janë shërbime të policisë gjyqësore të gjitha njësitë e Policisë së Shtetit, të policive dhe institucioneve të tjera publike, të cilave, sipas ligjit, organi kompetent u ngarkon detyrën parësore dhe të vazhdueshme të kryerjes së funksioneve të parashikuara në nenin 30 të këtij Kodi.

2. Oficeri që drejton shërbimet e policisë gjyqësore përgjigjet përpara prokurorit që drejton hetimin për zbatimin e detyrave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe në dispozita të tjera ligjore nga oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që varen prej tij.

3. Në rastet kur shërbimi i policisë gjyqësore është organizuar dhe ushtron funksionet e tij në shtrirje territoriale kombëtare ose në kompetencën territoriale të më shumë se një gjykate, oficeri drejtues i këtij shërbimi përgjigjet për çështjet e hetimit përpara prokurorit të prokurorisë, që drejton hetimin sipas kompetencës tokësore a lëndore të përcaktuar për këtë të fundit në bazë të Kodit të Procedurës Penale.

4. Në të gjitha rastet e tjera, oficeri drejtues përgjigjet përpara prokurorit të prokurorisë ku ndodhet qendra e shërbimit të policisë gjyqësore.

5. Oficerët drejtues të shërbimeve të policisë gjyqësore, sipas kriterëve dhe afateve të paragrafit të mësipërm, duhet t'i paraqesin prokurorit të prokurorisë kompetente listën e emrave, rolin dhe gradën përkatëse të oficerëve që bëjnë pjesë në shërbimet e policisë gjyqësore. Në rastin e transferimeve në detyrë tjetër dhe të zëvendësimeve përkatëse, ky njoftim duhet të bëhet jo më vonë se dhjetë ditë përpara kryerjes së këtyre veprimeve.

6. Transferimi në një detyrë tjetër ose ngritja në detyrë e drejtuesve të shërbimeve të policisë gjyqësore bëhet nga titullari përkatës i policisë, pasi të ketë marrë pëlqimin paraprak të Prokurorit të Përgjithshëm a të prokurorit që i është deleguar kjo e drejtë prej tij. Kundërshtimi i Prokurorit të Përgjithshëm duhet të jetë i motivuar dhe nuk mund të bëhet në rastet e gradimit të drejtuesve të shërbimeve të policisë gjyqësore.

7. Kërkimi i pëlqimit paraprak të Prokurorit të Përgjithshëm lidhur me ngritjen në detyrë, rol ose gradë, duhet të kërkohet deri në dy vjet nga data kur drejtuesi i shërbimit të policisë gjyqësore është transferuar ose nuk ushtron më funksione të tilla.

Neni 7

Organizimi i shërbimeve të policisë gjyqësore

1. Organi kompetent i policisë, në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore organike, është përgjegjës dhe kujdeset për ngritjen e shërbimit të policisë gjyqësore pranë çdo vendndodhje, ku kanë qendrën zyrat përkatëse të prokurorisë, si dhe për plotësimin me përbërjen dhe numrin organik

të nevojshëm për përmbushjen e funksioneve të tyre.

2. Organi kompetent, në rastet dhe mënyrat e parashikuara me ligj, si dhe në varësi të organizimit të pushtetit gjyqësor dhe të prokurorisë për ndjekjen e formave të veçanta të kriminalitetit, përgjigjet dhe kujdeset për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të posaçme të policisë gjyqësore.

KREU III SEKSIONET E POLICISË GJYQËSORE

Neni 8

Seksionet e policisë gjyqësore

1. Seksionet e policisë gjyqësore krijohen në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë. Në përputhje me ligjin, krijohen seksione të posaçme të policisë gjyqësore edhe në prokuroritë pranë gjykatave të tjera të sistemit gjyqësor.

2. Seksionet e policisë gjyqësore pranë prokurorive përbëhen nga oficerë dhe agjentë të policisë gjyqësore të caktuar nga titullarët kompetentë të policive dhe institucioneve të tjera publike, si dhe nga juristë.

3. Në përbërjen e seksionit të policisë gjyqësore, jo më pak se gjysma e numrit organik të tyre, janë oficerë të policisë gjyqësore. Juristët, me cilësinë e oficerit të policisë gjyqësore, mund të përbëjnë jo më shumë se një të katërtën e numrit organik të seksionit të policisë gjyqësore.

4. Sipas kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm, për kryerjen e hetimeve në çështje të posaçme që kërkojnë specializim të veçantë, titullarët e policisë a të institucionit publik përkatës vënë në dispozicion të prokurorit kompetent për hetimin, për gjithë periudhën e nevojshme të hetimit të posaçëm, oficerë ose agjentë të policisë gjyqësore që janë specialistë të fushave përkatëse. Personat e caktuar sipas kësaj pike nuk përfshihen në organikën e seksionit të policisë gjyqësore.

5. Organika e seksioneve të policisë gjyqësore përcaktohet në përputhje me nevojat dhe kërkesat për luftën kundër kriminalitetit, duke mbajtur parasysh numrin e prokurorëve, si dhe të personelit të policëve në shërbim pranë çdo njësie territoriale, ku ushtron kompetencën prokuroria përkatëse.

6. Prokurori i Përgjithshëm, në bashkërendim me Ministrin e Rendit Publik, Ministrin e Drejtësisë dhe ministrat që kanë në kompetencë forca policore, që ushtrojnë funksione të policisë gjyqësore, çdo dy vjet caktojnë organikën për çdo seksion të policisë gjyqësore, përbërjen policore, si dhe numrin përkatës të personelit që duhet të caktohet nga secila forcë policore.

7. Ministrat kompetentë, brenda gjashtëdhjetë ditëve nga përcaktimi i organikës së seksioneve të policisë gjyqësore, janë të detyruar të bëjnë plotësimin e numrit organik përkatës të oficerëve dhe agjentëve, të parashikuar për seksionet e policisë gjyqësore.

Neni 9

Drejtimi i seksioneve të policisë gjyqësore

1. Në ushtrimin e funksioneve të policisë gjyqësore, seksionet e policisë gjyqësore janë në varësi të titullarit të prokurorisë pranë së cilës janë ngritur. Ky i fundit, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e prokurorëve dhe gjykatës, drejton dhe bashkërendon veprimtarinë e seksionit të policisë gjyqësore.

2. Prokurori i një shkalle më të lartë ka në dispozicion të gjitha seksionet e policisë gjyqësore, që veprojnë në territorin përkatës në kompetencë të tyre.

3. Në seksionet e policisë gjyqësore, oficeri me gradë a kualifikim më të lartë, si rregull, është përgjegjës për oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore, që i përkasin policisë a institucionit ku ata bëjnë pjesë.

Neni 10

Kushte për caktimin si oficer dhe agjent në seksionet e policisë gjyqësore

1. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në seksione të policisë gjyqësore në rastet kur:

- a) në ngarkim të tyre ka të dhëna ose procedime penale ose policore;
- b) kanë zhvilluar veprimtari të policisë gjyqësore duke mos respektuar rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe kërkesat e ligjshme të prokurorit kompetent;
- c) kanë pasur procedime disiplinore në zbatim të dispozitave që rregullojnë veprimtarinë e policisë përkatëse;
- ç) kanë manifestuar qëndrime dhe marrëdhënie jokorrekte me pjesëtarë të personelit policor, si dhe jashtë detyrës së tyre.

2. Oficerët e policisë gjyqësore të efektivave të Policisë së Shtetit, duhet të kenë arsimin e lartë policor, ndërsa ata të organeve të tjera duhet të kenë arsimin e lartë juridik ose profesional të posaçëm në fusha të tjera të veçanta që lidhen me hetimin e veprave penale.

3. Agjentët e policisë gjyqësore duhet të jenë të paktën me arsim të mesëm.

Neni 11

Caktimi, transferimi dhe largimi nga seksionet e policisë gjyqësore

1. Ministri që ka në kompetencë forcën policore, menjëherë pas përcaktimit të organikës për çdo seksion të policisë gjyqësore ose të njoftimit për vende vakante në to, shpall konkurrimin për plotësimin e tyre, në të cilin mund të marrin pjesë oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore, që përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 9 të këtij ligji.

2. Brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së konkurrimin, oficeri dhe agjenti policor i interesuar për të punuar në seksionet e policisë gjyqësore, paraqet kërkesën përkatëse në shërbimin a komandën ku bëjnë pjesë, duke bashkëlidhur dokumentacionin që provon plotësimin e kushteve të pranimit.

3. Në çdo rast, kërkesa duhet të ketë të bashkëlidhur të dhënat vetjake të kandidatit dhe të dokumentit që vërteton se ai ka ushtruar veprimtari të policisë gjyqësore për një periudhë së paku dy vjeçare në pesë vitet e fundit të punës.

4. Në rastet kur numri i kërkesave të paraqitura nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar vendet vakante, të shpallura ose për të mundësuar miratimin nga Prokurori i Përgjithshëm, ministrat që kanë në kompetencë forcat policore, i dërgojnë këtij të fundit, për miratim dhe caktim përfundimtar një listë me kandidatë prej jo më pak se tre personash për çdo vend të paplotësuar, të përzgjedhur prej tyre ndërmjet oficerëve dhe agjentëve që përmbushin kushtet e pranimit në seksione të policisë gjyqësore.

5. Ministri që ka në kompetencë forcën policore, brenda 60 ditëve nga shpallja e konkurrimin, bën një vlerësim paraprak të kandidaturave të paraqitura dhe i paraqet Prokurorit të Përgjithshëm një renditje nominative të tyre, sipas kushteve dhe aftësive që zotërojnë, si dhe të nevojave të forcës policore.

Vlerësimi paraprak i kandidaturave bëhet nga një komision i përbashkët i Ministrisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Përbërja e komisionit dhe procedurat e seleksionimit, caktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

6. Lista e kandidaturave të paraqitura duhet të ketë bashkëlidhur kërkesën dhe dokumentacionin vetjak të të interesuarve.

7. Brenda 30 ditëve nga miratimi i Prokurorit të Përgjithshëm dhe dërgimi i kërkesës së tij nominale, Ministri, që ka në kompetencë forcën e policisë ku bën pjesë kandidati, e cakton në seksionin përkatës të policisë gjyqësore.

8. Juristët, në përbërje të seksioneve të policisë gjyqësore, caktohen në detyrë nga Prokurori i Përgjithshëm.

9. Largimi i oficerëve dhe agjentëve të seksioneve të Policisë Gjyqësore bëhet nga organi kompetent i forcës përkatëse policore sipas kërkesës së motivuar të prokurorit që drejton seksionin, pasi të ketë informuar Prokurorin e Përgjithshëm.

10. Transferimi, qoftë edhe i përkohshëm, i oficerëve dhe agjentëve të seksioneve të Policisë Gjyqësore bëhet sipas kërkesës së motivuar të organit kompetent të forcës policore, pasi të ketë marrë mendimin paraprak dhe pëlqimin e Prokurorit të Përgjithshëm a të prokurorit që i është deleguar kjo e drejtë prej tij. Kundërshtimi i Prokurorit të Përgjithshëm duhet të jetë i motivuar dhe nuk mund të bëhet në rastet e ngritjes në detyrë, rol ose të gradimi të oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore.

11. Kërkimi i pëlqimit paraprak të Prokurorit të Përgjithshëm, lidhur me ngritjen në detyrë, rol ose gradë, duhet të kërkohet deri në dy vjet nga data kur oficeri a agjenti i Policisë Gjyqësore është transferuar ose nuk ushtron më funksione të tilla.

Neni 12

Pozita juridike dhe karriera e oficerëve dhe agjentëve të seksioneve të policisë gjyqësore

1. Pozita juridiko-administrative dhe karriera e oficerëve dhe agjentëve të seksioneve të policisë gjyqësore, përveç kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj, rregullohen nga legjislacioni përkatës për policinë ku ata bëjnë pjesë.

2. Oficerët dhe agjentët e seksioneve të policisë gjyqësore, me kërkesë a miratim të drejtuesit të seksionit, mund të përjashtohen nga përdorimi i uniformës dhe, në çdo rast, duhet të jenë të pajisur me një distinktiv të numërtuar, që mbahet me vete dhe vendoset përmbi uniformë.

3. Oficerët dhe agjentët e seksioneve të policisë gjyqësore nuk mund të ngarkohen me detyra që nuk kanë lidhje me veprimtari të policisë gjyqësore, që i janë caktuar ose deleguar nga prokurori kompetent, përveç rasteve të urgjencës ose për nevoja të stërvitjes, për të cilat është njoftuar dhe marrë pëlqimi i drejtuesit të prokurorisë pranë së cilës funksionon seksioni i policisë gjyqësore.

KREU IV

PËRGJEGJËSIA E OFICERËVE DHE AGJENTËVE TË POLICISË GJYQËSORE

Neni 13

Drejtimi dhe kontrolli

1. Ushtrimi i veprimtarisë së policisë gjyqësore nga oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore drejtohet dhe kontrollohet nga prokurori, sipas rregullave të caktuara në Kodin e Procedurës Penale.

2. Drejtuesit dhe strukturat përgjegjëse të policive, të ngarkuara me ushtrimin e funksioneve të policisë gjyqësore, kanë për detyrë të përmbushin dhe mbështetin realizimin e këtyre funksioneve dhe mbajnë përgjegjësi, sipas ligjit për çdo pengim të saj.

3. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore, lidhur me të dhënat dhe ecurinë e hetimit, duhet të përgjigjen dhe të raportojnë vetëm te prokurori kompetent.

Neni 14

Përgjegjësia e oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore

1. Përveç kur përbëjnë vepër penale, janë shkelje e disiplinës në ushtrimin e detyrës nga oficerët dhe agjentët e shërbimeve dhe të seksioneve të policisë gjyqësore veprimet dhe mosveprimet

si vijon:

- a) raportimi i të dhënave mbi hetimin jashtë zyrës së prokurorit;
- b) fshehja e të dhënave ose mosnjoftimi në gjykatë ose prokurori për kryerjen e një vepre penale, në përputhje me afatet dhe mënyrën e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale;
- c) moskryerja, kryerja me vonesë ose ekzekutimi i pjesshëm i një urdhri të ligjshëm të gjykatës a prokurorit, që lidhet me ushtrimin e funksioneve të policisë gjyqësore;
- ç) kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

2. Procedimi disiplinor kundër oficerit a agjentit të policisë gjyqësore që akuzohet për shkelje të rëndë të disiplinës në ushtrimin e këtyre funksioneve, fillon nga prokurori i prokurorisë, që drejton seksionin e policisë gjyqësore ku ai bën pjesë ose ku ndodhet qendra e shërbimit të policisë gjyqësore.

3. Për fillimin e procedimit disiplinor, prokurori kompetent njofton menjëherë Ministrin që ka në kompetencë forcën policore dhe drejtuesin e shërbimit të policisë gjyqësore ose të njësisë a repartit të forcës policore, ku bënte pjesë oficeri dhe agjenti i policisë gjyqësore.

4. Për shkelje të tjera disiplinore, të ndryshme nga ato të treguara në pikën 1 të këtij neni, prokurori kompetent njofton menjëherë Ministrin që ka në kompetencë forcën policore dhe drejtuesin përkatës të shërbimit të policisë gjyqësore, ku bën pjesë oficeri dhe agjenti i policisë gjyqësore, të cilët procedojnë sipas dispozitave ligjore përkatëse.

Neni 15

Procedimi disiplinor

1. Oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore që akuzohet për shkelje të rëndë të disiplinës në ushtrimin e funksioneve të policisë gjyqësore, njoftohet me shkrim për shkaqet, faktet dhe dispozitat e shkelura për të cilat procedohet me masë disiplinore, për të drejtën e tij për të përgatitur mbrojtjen, si dhe për datën e zhvillimit të gjykimit disiplinor.

2. Oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore, që i nënshtrohet procedimit disiplinor, brenda 10 ditëve nga ajo e zhvillimit të gjykimit disiplinor, mund të paraqesë mbrojtjen e tij me shkrim, dokumente, si dhe të kërkojë thirrjen dhe dëgjimin e dëshmitarëve.

3. Gjykimi disiplinor përbëhet nga një komision që kryesohet nga një prokuror i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë kompetente për territorin dhe nga dy oficerë të policisë gjyqësore. Anëtarët e komisionit caktohen për një afat njëvjeçar, përkatësisht nga drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës kompetente dhe nga drejtuesi rajonal i forcave policore ku bën pjesë oficeri ose agjenti, që kërkohet t'i nënshtrohet procedimit disiplinor.

4. Akuza kundër oficerit ose agjentit të policisë gjyqësore bëhet nga prokurori që ka kërkuar procedimin disiplinor ose një zëvendësues i caktuar prej tij.

5. Oficeri ose agjenti, që i nënshtrohet procedimit disiplinor, ka të drejtën e mbrojtjes me një mbrojtës të zgjedhur ndërmjet pjesëtarëve të forcës së tij policore ose avokatëve.

6. Vendimi i komisionit jepet në përfundim të procedimit disiplinor, gjatë së cilës prokurori që bën akuzën dhe personi që kërkohet të ndëshkohet paraqesin provat e tyre. Në rast të mendimeve të ndryshme, komisioni vendos me shumicë votash.

7. Kundër vendimit të komisionit disiplinor, lidhur me masat disiplinore të parashikuara në shkronjat "b" e "c" të pikës 10 të këtij neni, prokurori ose personi i ndëshkuar kanë të drejtën e ankimit në gjykatë.

8. Komisioni disiplinor ose gjykata, gjatë gjykimit të çështjes, mund të vendosin pezullimin nga ushtrimi i funksioneve të policisë gjyqësore të oficerit dhe agjentit të akuzuar.

9. Vendimi përfundimtar i ndëshkimit disiplinor dhe ai i pezullimit në ushtrimin e funksioneve të policisë gjyqësore ekzekutohen menjëherë nga drejtuesi kompetent i forcës policore, ku bën pjesë oficeri ose agjenti i proceduar.

10. Masat disiplinore kundër oficerit ose agjentit fajtor të policisë gjyqësore, sipas rëndësisë së shkeljes disiplinore, janë si vijon:

vërejtje me paralajmërim;

b) pezullim nga marrëdhëniet e punës për një periudhë deri në gjashtë muaj;

c) largim nga detyra.

11. Me ndëshkimin disiplinor, oficerët dhe agjentët e seksioneve të policisë gjyqësore largohen nga seksioni i policisë gjyqësore, ndërsa për ata të shërbimeve të policisë gjyqësore zbatohen dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e forcës policore ku bëjnë pjesë.

KREU V DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 16

Riorganizimi i policisë gjyqësore

1. Brenda muajit dhjetor të vitit 2000 të përfundojë riorganizimi dhe funksionimi i shërbimeve dhe seksioneve të policisë gjyqësore pranë prokurorive, në përputhje me rregullat e caktuara në këtë ligj.

2. Titullarët e forcave policore dhe të institucioneve të tjera publike, që ushtrojnëtribute të policisë gjyqësore, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, duhet t'i paraqesin Prokurorit të Përgjithshëm listën e emrave, rolin dhe gradën përkatëse të oficerëve që drejtojnë shërbimet e policisë gjyqësore.

Neni 17

Dispozita zbatuese

Prokurori i Përgjithshëm, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Rendit Publik, si dhe ministrat që kanë në kompetencë forca policore që ushtrojnë funksione të policisë gjyqësore, bashkërisht ose veçmas, nxjerrin urdhëra dhe udhëzime në zbatim të neneve 5, 6, 7, 10, 11, 14 dhe 15 të këtij ligji, si dhe lidhur me çështjet si vijon:

a) Shkëmbimi i informacioneve ndërmjet seksioneve dhe shërbimeve të policisë gjyqësore për çështje që lidhen me bashkërendimin e luftës dhe gjendjen e kriminalitetit.

b) Planifikimi, bashkëredimi dhe organizimi e veprimtarive stërvitore, edukuese dhe trajnuese për oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore.

c) Bashkërendimi dhe organizimi i veprimtarisë së shërbimeve dhe të seksioneve të policisë gjyqësore për zbatimin e detyrave procedurale nga ana e oficerëve dhe agjentëve të tyre.

Neni 18

Shfuqizimi i akteve

Dekreti nr.1188, datë 10.8.1995 "Për policinë gjyqësore" shfuqizohet.

Neni 19

Hyrjanë fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2798, datë 20.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

L I G J
Nr.8679, datë 2.11.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7962, DATË 13.7.1995
“PËR ENERGINË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 13 të ligjit nr.7962, datë 13.7.1995 “Për energjinë elektrike” bëhen këto ndryshime:

1. Në titull dhe në paragrafin e parë shkronja “b”, fjala “të përtëritshme” zëvendësohet me fjalën “të rinovueshme”.

2. Në fund të shkronjës “b” shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

“Burime të rinovueshme janë:

- energjia diellore në të gjitha aplikimet e saj;
- energjia e erës;
- energjia gjeotermike e të gjitha llojeve;
- energjia hidrike;
- energjia e biomasës në të gjitha aplikimet e saj.”

3. Pas paragrafit të katërt shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

“a) Duke filluar nga 1 janari 2001, furnizuesi dhe të gjithë prodhuesit e tjerë të pavarur të energjisë elektrike mbi 2 MW janë të detyruar të prodhojnë, për sistemin elektroenergjitik shqiptar, energji elektrike nga burime të energjive të rinovueshme, në masën 2 për qind të të gjithë sasisë së energjisë elektrike të prodhuar prej tyre nga burime të tjera.

b) Detyrimi i mësipërm vlerësohet i plotësuar edhe duke blerë kuotën e njëvlefshme të energjisë elektrike nga prodhues të tjerë vendas ose duke e importuar nga vende të tjera. Ky detyrim vlerësohet i përmbushur kur Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dokumenton se energjia elektrike e importuar është e prodhuar nga burime të rinovueshme.

c) Në rastet e mosplotësimit të këtij detyrimi, Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike ka të drejtë të gjobisë në masën 50-100 për qind të vlerës së këtij detyrimi, si dhe të ndalojë ushtrimin e veprimtarisë së tyre, përsa kohë që ata të plotësojnë këtë detyrim.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2794, datë 17.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8682, datë 7.11.2000

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8405, DATË 17.9.1998 “PËR URBANISTIKËN”,
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8501, DATË 16.6.1999**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, ndryshuar me ligjin nr.8501, datë 16.6.1999, bëhet ky ndryshim:

Në nenin 51 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përfshihen komunat që kryejnë investime me fondet e FZSHH-së nga pagesa e 1 për qind e vlerës së investimit sipas preventivit të objektit për llogari të financimit të studimeve urbanistike të pushtetit vendor dhe 1 për qind për rikonstrukcionin e rrjeteve të infrastrukturës nga organet e pushtetit vendor.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2797, datë 17.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 20.11.2000
Doli nga shtypi më 24.11.2000

Tirazhi: 3700 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Çmimi: 150 lekë